REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2
TEL: 042255528

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 12155** **Nr. koleksioni: 3826**

**Tirane më 28/12/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2022053950405245359

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2022053950405245359

Taksa e Pullës u Likujdua

**KONTRATË SHITJE KUOTE**

Sot, më datë 28.12.2022 (dy mijë e njezete e dy) përpara meje Noterit Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, u paraqitën palët e mëposhtme:

**SHITESIT**:
**Gentian Parruca**, atësia Bardhyl, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Eduard Mano 03910036; Nd. 8; H. 15; Ap. 3; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 05/07/1978, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038096790 dhe nr. personal H80705059H,

**Enkelejd Karanxha**, atësia Sotiraq, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në TIRANË, me adresë Babë Rexha; Nd. 11; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/05/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033774484 dhe nr. personal H80513206T,

**dhe**

**BLERESI**:
**Redon Iljasllari,** atësia Gëzim, amësia Lirie, shtetas Shqiptar, lindur në Pogradec dhe banues në POGRADEC, me adresë Komuna E Bucimasit 02640064; Nd. 214; H. 1; Buçimas; Remenj; 7304; Pogradec, lindur më 20/09/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032083742 dhe nr. personal J50920039E;

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

**MEQENËSE:**

**A.** Shoqëria "FOCUS ARCHITECTURE" Sh.P.K. (ne vijim "***Shoqeria***"), shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS L91325024S, me kapital themeltar prej 100.000,00 Lekë.
**B.** Shitësit i kane njoftuar Blerësit ofertën e tyre për shitjen e 20% te kapitalit themeltar te Shoqerise (konkretisht 10% te kapitalit e shet Z. Gentian Parruca dhe 10% te kapitalit e shet Z. Enkelejd Karanxha) tek bleresi Z. Redon Iljasllari dhe Blerësi ka pranuar të blejë 20% te kapitalit te zotëruar dhe të ofruar nga Shitësit në Shoqëri.
**C.** Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

**ATËHERË,** duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

**Neni 1** **Objekti**

A2022053950405245359

**1.1.** Nëpërmjet këtij Kontrate Shitësi i shet Blerësitne total 20% te kapitalit, pra konkretisht 10% (dhjete përqind) të kapitalit themeltar te Shoqerise te zoteruar nga Gentian Parruca dhe 10% (dhjete perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise te zoteruar nga Enkelejd Karanxha tek Blerësi Z. Redon Iljasllari i cili blen nga Shitësit ne total 20% te kapitalit themeltar te Shoqerise "FOCUS ARCHITECTURE" Sh.P.K shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS L91325024S.

**Neni 2 Çmimi**

**2.1** Çmimi i shitjes së kuotes është LEKE 20.000 (njezete mije leke).

**2.2** I gjithe cmimi i shitjes se kuotes eshte paguar rregullisht nga bleresi ne favor te shitesit jashte zyres noteriale dhe perpara nenshkrimit te kesaj kontrate. Bleresi e deklaron te shlyer plotesisht cmimin e shitjes se kuotes dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje likujdimin e saj, as tani e as ne te ardhmen.

**Neni 3 Deklarimet dhe garancite**

**3.1** Shitësi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuoten që do të transferohet sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t`a transferuar këte kuote dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi.

**3.2.** Bleresi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësit kane tagra të plota për të pranuar kuoten nga Shitësi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

**Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi kuotat**

**4.1.** Pronësia mbi kuoten e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kjo Kontrate per kalimin e pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit, do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar, duke pasqyruar edhe ndryshimin ne strukturen e zoterimit te kapitalit themeltar te Shoqerise.

**4.2.** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuoten e zotëruar në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 5 Të ndryshme**

**5.1.** Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

A2022053950405245359

**5.2.** Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, te ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

**5.3.** Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**5.4.** Kjo Kontratë hartohet në gjuhën Shqipe në 4 (kater) origjinale.

Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet që passjell.

**SHITËSI**
Enkelejd Karanxha

Gentian Parruca

**BLERËSI**
Redon Iljasllari

**NOTER**
**JULIAN ZHELEGU**

A2022053950405245359

**VENDIM**
**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**"FOCUS ARCHITECTURE" Sh.P.K.**

Shoqëria "FOCUS ARCHITECTURE" Sh.P.K. është person juridik shqiptar, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L91325024S.

Sot me date 28 . 12 .2022 u mblodh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, ne mungese te nje akti formal thirrjeje, por me prezencen dhe miratimin e te gjithe ortakeve qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit the Shoqerise, te cilet vendosin dhe bien dakord te vijojne me shqyrtimin e çeshtjeve te meposhtme te rendit te dites dhe marrjen e vendimeve te vlefshme ne lidhje me to:

1. Miratimi i shitjes se gjithsej 20% te kapitalit e konretisht 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohen nga ortaku Gentian Parruca dhe 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohen nga ortaku Enkelejd Karanxha ne favor te Z. Redon Iljasllari.
2. Te tjera, eventuale.

Pasi shqyrtuan çeshtjet e mesiperme te rendit te dites, në bazë të Ligjit 9901/2008 "Për tregetaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me unanimitet:

**VENDOSI:**

3. Te miratoje shitjen e gjithsej 20% te kapitalit, konkretisht 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohen nga ortaku Gentian Parruca dhe 10% te kuotave te kapitalit te Shoqerise qe zoterohen nga ortaku Enkelejd Karanxha ne favor te Z. Redon Iljasllari.
   1) Te autorizoje palet e mesiperme te lidhin kontratat / marreveshjet perkatese pa asnje kufizim kohor dhe pa asnje kufizim ne lidhje me kushtet dhe afatet per te cilat keto pale mund te bien dakord.
   2) Shprehimisht hiqet dore nga çdo e drejte parablerjeje dhe/ose e drejte tjeter ne lidhje me kuotat qe do te transferohen si me siper.
   3) Te kryhen depozitimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me ligjet ne fuqi.

Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve:

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

| **Enkelejd Karanxha** | **Gentian Parruca** |
| --- | --- |
| Enkelejd Karanxha | Gentian Parruca |

STUDIO PROJEKTIMI FOCUS ARCHITECTURE NUIS: L91325024S